VENDIM
Nr. 283, datë 7.11.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALB ENERGY TRADE" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e" dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885 prot, datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Alb Energy Trade' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike" dhe qëndrimin e këshilltares së Bordit,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 14.10.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Alb Energy Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, pasi dokumentacioni i depozituar nga shoqëria nuk ishte sipas ndryshimeve të rregullores të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 220/2022, si dhe nuk ishte realizuar pagesa e aplikimit për t'u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas marrjes së këtij vendimi, me shkresën e protokolluar me nr. 1770/2 prot., datë 17.10.2022, shoqëria ka bërë me dije se ka kryer dhe diferencën e pagesës që përkon me pagesat e reja të aplikimit.

- ERE, me shkresën nr. 1770/3 prot., datë 25.10.2022, ka orientuar shoqërinë se nëse brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e këtij vendimi për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin sipas kërkesave të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dokumentacioni i paraqitur në aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Brenda afatit 1-mujor, sikurse përcaktuar në nenin 10, pika 7, të rregullores, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1770/4 prot., datë 28.10.2022, ka paraqitur dokumentacion për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Alb Energy Trade" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a" dhe

“d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikë 2.5 të rregullores. Nga ky aplikim rezulton se shoqëria duhet të plotësojë:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penalitetit) për vetë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. dhe për administratorin e saj.
- Germa “c”: Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse është bërë miratimi i strukturës organizative të saj dhe në kuptim të kërkesave specifike të këtij neni, shoqërisë do t’i kërkohet informacion mbi stafin teknik që do të angazhohet me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në strukturën organizative përfundimtare të saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k,. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti